



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 20

Datë: 26. 06. 2023. Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr .19/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Komiteti i Auditimit

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i punëtorisë "Harmonizimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme "

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2026

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Mbasi që kryetari Radoniqi e paraqiti agjendën e mbledhjes, anëtari Arianit Elshani, propozoi që pika nga DOZ: "Harmonizimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së me Ligjin për Zgjedhjet e përgjithshme " të bartet si pikë e rendit të ditës bashkë me projekt – propozimin për buxhet në kuadër të Sekretariatit. KOZ-i e ka shqyrtuar këtë projekt, dhe janë dhënë rekomandimet gjë që, besoj se Sekretariati ka ndërmarrë veprimet... Prandaj, kjo pikë të bartet te Këshilli për Buxhet...

Me ndryshimet e propozimit të z. Elshani, anëtarët e KQZ-së miratojnë rendin e ditës.

Në vazhdim, me 10 vota për miratohet procesverbali nr. 19 nga mbledhja e kaluar (me një vërejtje nga z. Sami Kurteshi në diskutimet – citimet e tij në proceverbal).

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Në raportin e tij mes dy takimeve, kryeshefi i Sekretariatit Burim Ahmetaj theksoi disa aktivitete dhe prioritete të Sekretariatit. Fillimisht, i tha se është duke përgatitur "matrica" me të gjitha ndryshimet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili pritet së shpejti të hyjë në fuqi. "Matrica", tha z. Ahmetaj, përmban të gjitha ndryshimet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e cila është duke u plotësuar nga përgjegjësit, nga secili departament apo njësi. E njëjta, do ti shërbejë KQZ-së gjatë metodologjisë së plotësim ndryshimeve të rregulloreve. Lidhur me këtë aktivitet, u tha se para punëtorisë për plotësim – ndryshimin e Rregulloreve zgjedhore, "matrica" së bashku me plotësim-ndryshimet për secilën rregullore, do të trajtohet në KOZ.

Nga raporti, Ahmetaj theksoi se janë duke i draftuar edhe dy Rregullore të reja: 1. Rregullorja "Qendrat Komunale të Numërimit". 2. Rregullorja për "Referendume".

Në vazhdim, u tha se më datën 22.06.2023, me kërkesën të Sekretariatit të KQZ, kryeshefi ekzekutiv së bashku me drejtorin e DTI-së janë takuar me zv. drejtorin e Agjencisë për Shoqërinë e Infomacionit (në kuadër të MPB). Në takim, është diskutuar në lidhje më mbështetjen nga ASHI për KQZ në fushën e TI-së, me theks të veçantë për disa kërkesa specifike të cilat janë paraqitur në takim dhe në vijim gjeni informatën më të detajuar.

Sipas ligjit nr. 04/L-145 për “Organet e shoqërisë së informacionit”, përkatësisht nenit 10, ku thuhet se: “...Institucionet të cilat gëzojnë pavarësi kushtetuese, të cilat janë të përjashtuara nga zbatimi i këtij ligji, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje mirëkuptimi me ministrinë përgjegjëse për administratë publike për ato fusha për të cilat këto institucione mund të përfitojnë nga agjencia për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit”, KQZ vlerëson se është e dobishme për të dy palët që bashkëpunimi të konkretizohet me marrëveshje të përbashkët dhe ku pastaj, do të pasohen edhe aspektet dhe fushat e bashkëpunimit të KQZ-së me ASHI-në.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është me rëndësi të theksohet fakti se KQZ mund t’i siguroj kapacitetet e ruajtjes dhe mbajtjes së informacioneve të veta. KQZ, e ka hapësirën e dhomës se serverëve e cila nuk përmbush kriteret e duhura prandaj, mendojmë që serverin ta transferojmë në qendrën shtetërore të të dhënave (në ASHI). Po ashtu, edhe gjatë zgjedhjeve mund t’ofrohen kapacitete të serverëve dhe të hapësirës shtesë nga ASHI në përballimin e trafikut dhe ruajtjen e informatave. Ashtu sic, kemi rënë dakord, tha më tej në raportin e tij z. Ahmetaj, ekipet tona teknike të përbashkëta do të takohen në dy javët e para të korrikut për të diskutuar fillimin e transferimit të serverëve dhe pajisjeve përcjellëse në qendrën shtetërore të të dhënave ku, edhe janë kushtet sipas standardeve (interneti, rryma, klimatizimi, etj).

Jemi në rrugë të mirë, dhe besojmë se ASHI, do të ofrojë kapacitete të serverëve dhe hapësirës sipas nevojës së KQZ-së, tha Ahmetaj.

Përgjatë takimit, e kemi diskutuar edhe paisjen me kartelat VIP për anëtarët e KQZ-së. Besojmë se së shpejti, ashtu sic jemi marrë vesh, do ta dërgojmë kërkesën dhe kartelat do të prodhohen e lëshohen në përdorim nga anëtarët e KQZ-së. Sekretariati, tashmë e ka dërguar kërkesën...

Mbikëqyrja e zhvillimit të softuerit të integruar të rezultateve, është në fazën testuese për secilin modul. Por, testimi do të marrë kohë edhe përgjatë dy muajve të tjerë, ka thënë z. Ahmetaj, i cili po ashtu, i ka informuar anëtarët e KQZ-së edhe me plotësim – ndryshimet e Udhëzimeve Administrative të cilat, janë në proces e sipër...

Illir Gashi, foli rreth “matricës”, aktiviteteteve ligjore që kanë ndodhur, ndryshimet e reformës zgjedhore, identifikimet e tyre. Veç aktiviteteteve, jeni duke u marrë edhe me rregulloren e qendrave komunale. Shpresoj shumë që, tha z. Gashi, do ta bëni një rregullore të mirë... Po ashtu, edhe rregullorja për referendum. Nuk më kujtohet nëse ne, kemi diskutuar për këtë, ose e kemi autorizuar Sekretariatit për një rregullore të këtillë! Se di kush ka rekomanduar, por e di që ne se kemi diskutuar. Nga ka dalë ky rekomandim, ky aktivitet...?

Sami Kurteshi: Unë prita të ishte një rregullore për votim jashtë vendit që, duhet bërë. Kjo. Nuk po dua me përsëritë, por ne nuk kemi ligj për me ba një rregullore të këtillë. Kjo, mendoj që duhet të hiqet sepse nuk ka bazë, kurse rregullorja për votim jashtë vendit duhet të futet në plan të punës...

Alban Krasniqi: Mua më duket e çuditshme, por edhe shqetësuese se nga ka dalë. Në fund të fundit, nuk ka edhe bazë... sikur duhet t’i rrimë mbi krye Sekretariatit, sepse kjo është shqetësuese dhe ja, na futet diçka që, së paku ishte dashur së pari të diskutohej në këshilla...Na futet diçka pa dijeninë tonë. Lidhur me takimin me ASHI-në e MPB-së, edhe kjo, duhet të kaloj procesi në këshillat përkatëse. Paraprakisht, KOZ – i duhet diskutojë, por edhe te këshilli për çështje ligjore...Kemi të bëjmë me bartje të disa shërbimeve, dhe ne të sigurohemi që duhet të bëhen ato në mënyrë të duhur... Çfarëdo finalizimi i marrëveshjes, paraprakisht, duhet kaluar së pari nëpër këshilla...

Arianit Elshani: E para, lidhur me raportimin mbi ndryshimet lidhur me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, draft – plotësimin e ndryshimeve, harmonizimin e rregullave zgjedhore... Kemi punue gjatë në këto rregulla, duke lënë hapësirë edhe për ndryshime në raport me reformën zgjedhore...

Konsideroj se, keni ndarë kohë për shqyrtimin e këtyre rregullave, të zhvillojmë takime ë veçanta për secilën rregull, ti harmonizojmë, ta shohim aspektin operacional që, disa operacione do ti kemi për herë të parë...Pra, ta analizojmë secilin aktivitet ...

Sa i përket rregullës për referendum, ndoshta është mirë që ta shohim, ta parashohim se si zhvillohet një proces i këtillë... Në rast se për shembull, do të kishin një petition nga qytetarët për ndonjë referendum...

Z. Elshani, foli edhe për bashkëpunimin me ASHI-në, dhe e vlerësoi si një “bashkëpunim” shumë të rëndësishëm për KQZ-në... Shpresoj, ta kemi shpjet në KQZ një draft-marrëveshje.

Ibrahim Selmanaj, pyeti rreth vendimit për materialet e QNR-së, për ato materiale që nuk hyjnë më tej në punë. Pra, ku është sekretariati, në cilën fazë...?

Rreth marrëveshjes me ASHI-në, z. **Ilir Gashi**, tha se rreth marrëveshjes me ASHI-në, tha se KOZ dhe KCL duhet të merren me shqyrtim dhe analizë, sepse ne jemi institucion i pavarur dhe duhet ta dimë se deri ku mund të shkojmë në këtë drejtim. Nuk duhet të ngutemi, duhet pa se si e qysh duhet të jetë “korniza” e bashkëpunimit, pra kur është fjala për institucionet e jashtme ne, duhet të kemi krejt të qartë se si dhe qysh mund të bashkëpunojmë...

Lidhur me “souftverin”, ku thuhet se do të duhen edhe nja dy muaj për testimin e tij, tha z. Elshani. Nuk jam dakord me këtë pikë... Po ashtu, z. Elshani, tha se bashkëpunimi me ASHI-në nuk cenon institucionin lidhur me bashkëpunimin, sidomos në shërbimet e përbashkët. Nuk ka të dhëna që askush tjetër mund të ketë qasje...

Lidhur me çështjen e rregullës së referendumit, diskutoi përsëri **Sami Kurteshi**. Ndërsa në vazhdim, **Kreshnik Radonqi** tha se, ndoshta ish dashtë të kishim një “rregullore” në relacion apo nga obligimet që dalin nga neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Ndoshta termi, emri, nuk është adekuat në raportin e kryeshefit por, nuk është mirë që në një rast ne, të mos kemi shumë ide apo të jemi në një pozitë procedurale që të mos jemi të gatshëm për një obligim që na takon ne...

Lidhur me raportin e kryeshefit, në fakt lidhur me bashkëpunimin me ASHI-në dhe me rregulloren eventuale për Referendume, diskutuan: Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, ndërsa në pyetjet e shtruara dhe analizat e tjera, u përgjigj kryeshefi Ahmetaj.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Komiteti i Auditimit

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Sami Kurteshi: Faleminderit. Komiteti i Auditimit ka mbajtur takim, ka diskutuar rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. E keni marrë raportin, e keni trajtue besoj, aty është edhe plani i veprimit. A e keni pa planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve. Urdhëroni nëse keni diçka...?

Sami Hamiti: Rreth kësaj, i falënderoj. Ishte një kërkesë që ne ta kemi raportin si anëtar të KQZ. E kam analizuar. Realisht, është një raport që ka njëfarë kundërshtie mes “opinionit dhe “pjesës tjetër” që unë i konsideroj “konkluzione”! Kur ti krahasosh, “opinionet dhe konkluzionet”, ka njëfarë divergjence. Të

gjeturat, pasqyrat janë minore dhe kjo tregon se, është punuar në bazë të standardeve. Është punuar mirë nga KQZ, por “opinionet” janë si rezultat i mos korrespondimit të brendshëm, efikas...

Në anën tjetër, përmbajuni atyre që janë të gjetura, pra të përmirësohen ato “të gjetuna” ashtu si janë, edhe pse janë minore. Zbatoni edhe rekomandimet që vijnë nga Zyra Kombëtare se, nuk është ndonjë problem...

Sami Kurteshi, tha se, duhet bërë bërë presion te stafi sepse, nuk duhet me na ardhë gjetje të këtilla që s’janë problem me u kry. Mendoj që raporti i ardhshëm i ZKA, të jetë pa vërejtje. Kjo, mund të bëhet, mund të arrihet...

Arianit Elshani, tha se, të gjeturat janë pothuajse të një fushe: të e-pasurisë! Por, ka edhe një detaj: e ai është lidhur me zyrtarin kryesor finansionar. Pra, ka pasur problem këtu për shkak të dualizmit të funksionit. Duhet të kemi vetëm një zyrtar të ZKF-së! Sekretariati, konsideroj që ka marrë, ose duhet marrë masa... Nuk mund të kemi zyrtar që luajnë, apo kanë dy përgjegjësi në të njëjtën kohë...

Alban Krasniqi, tha se komunikimi i brendshëm nuk është në nivel, u tha këtu! Ajo që mungon, është ndërmarrja e masave administrative dhe të tjera! Një fakt është tjetër: raporti i auditorit është i kualifikuar. Një fakt tjetër, kur është dërguar draft raporti nga auditori, nuk ka pas një komunikim të brendshëm paraprakisht, në mënyrë që të përmirësohet. Kjo, do të ndikonte për mirë, por kjo s’ka ndodh! Duhet gjetur fajtorët se, një plan i punës ka ekzistuar, prandaj secili duhet zbatoj detyrat dhe duhet marrë masat...

Pyetja e z. Selmanaj rreth pasurisë, tjetërsimi i pasurisë, që, me ankand ose në format të tjera – shkruhet si bëhet sipas udhëzimit administrativ... KQZ e ka marrë një vendim, prandaj sa “pasuri” është tjetërsu sipas procedurave që ekzistojnë, dhe ku ka mbet procesi...? Nuk janë informacione ekskluzive, prandaj krejt këto informacione është mirë me u bartë edhe te këshillat, edhe te anëtarët e KQZ-së...Aty ku nuk jeni të sigurt, është mirë me bashkëpunue, me i pyet institucionet tjera pra, çështjet me i definue saktë...

Të gjitha këto, ne mandej të mos kemi raporte me të gjetura, me rekomandime...

Sami Hamiti: Deri më sot, nuk ka pas raport në ZKA më me pak vërejtje, të gjetura, rekomandime! Pra, gjithçka, në konceptin e gjithë raportit janë aq të vogla vërejtjet dhe ato mund të përmirësohen, të rritet komunikimi...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e këtij raporti ?

Me vota unanime miratohet plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

3.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2026

Arianit Elshani, fillimisht vlerësoi angazhimin e bërë nga KQZ në hartimin e kësaj strategjie. Që nga viti 2018 KQZ nuk ka pas një plan strategjik. Përgjatë gjithë kohës, kemi identifikuar shqyrtuar e hartuar aktivitetet, shtyllave strategjike, objektivave etj. Konsideroj se ajo që ka qenë e rëndësishme, KQZ ka arritur të përmbush vizionin dhe planin brenda këtij dokumenti: gjatë periudhës zgjedhore, por edhe jashtë periudhave zgjedhore brenda synimeve, procedurave, dhe misionit që kemi. Meqenëse, kemi dhënë edhe mendimet tona, shqyrtimet, kontributin qoftë si departamente, këshilla, dhe si KQZ rekomandojmë që të aprovohet ky dokument, tha z. Elshani.

Kreshnik Radoniqi: Fillimisht, e hedh në votim Planin Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2023-2026. Kush është për miratimin e këtij plani ?

Faleminderit, dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj OSBE-në dhe zyrën e BE-së për mbështetjen dhe kontributin e tyre.

Me 10 vota, u miratua ky plan.

4.Këshilli për Buxhet

Shqyrtimi dhe miratimi i punëtorisë "Harmonizimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithëshme

Burim Ahmetaj: Sekretariati ka përgatitur planin për organizimin e një punëtorie lidhur me harmonizimin e të gjitha rregullave zgjedhore të KQZ-së në relacion me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Është përgatitur edhe buxheti. Punëtorja, do të zgjas 5 ditë. Kjo punëtori, planifikojmë të mbahet nga data 7 – 11 korrik.

Kreshnik Radoniqi: Kush, është për miratimin e planit të buxhetit të kësaj punëtorie ?

Me vota unanime miratohet buxheti, pastaj edhe "agjenda" e punëtorisë.

